

V E N D I M
Nr.425, datë 6.8.1993

**PËR MIRATIMIN E KREDISË TË NËNSHKRUAR NDËRMJET QEVERISË
SHQIPTARE DHE BANKËS BOTËRORE**

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e kredisë prej 2,9 milionë SDR (4,6 USD), të akorduar nga Shoqata e Zhvillimit Ndërkombëtar (IDA), e cila do të përdoret për zbatimin e projektit të asistencës teknike për reformën ekonomike.

2. Njësia e zbatimit të projektit të importeve kritike pranë Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë ngarkohet:

a) Të hartojë kontratat e punësimit të konsulentëve të huaj, në përputhje me procedurat e IDA-s.

b) Të kryejë veprimtarinë e blerjeve, në përputhje me procedurat e IDA-s.

c) Të bashkërendojë e kontrollojë zbatimin e programeve të trajningut, në bashkëpunim me agjencitë përfituese të përfshira në projekt.

ç) Të kryejë kontrollin financiar e të ndjekë procedurat e kthimit të kredisë.

3. Vlerësimi i kontratave të punësimit dhe të blerjeve do të bëhet nga institucionet dhe agjencitë përfituese të përfshira në projekt, në bashkëpunim me Njësinë e zbatimit të projektit të importeve kritike, në përputhje me procedurat e IDA-s.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të ligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë së zhvillimit për asistencë teknike për reformën ekonomike ndërmjet Shqipërisë dhe Shoqatës së Zhvillimit Ndërkombëtar (IDA)".

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi